



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:032449
Datë: 09.10.2024
Numri i dokumentit: 06272479

C.nr.549/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtare Diora Bajrami, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve S.D., R.B., Dž.E., L.S., Dž.M., A.P. që të gjithë nga Prizreni të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. Asdren Saramati nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson e autorizuar V.I.Xh. me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 4,253.1 euro, jashtë seance, me datë 09.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve S.D., R.B., Dž.E., L.S., Dž.M., A.P. që të gjithë nga Prizreni.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve të kompensohen në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:
 1. Paditësit S.D. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 21.11.2022 në shumën e përgjithshme prej 694.04 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (29.01.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.
 2. Paditësit R.B. për periudhën kohore 01.01.2021 – 21.11.2022 në shumën e përgjithshme prej 694.04 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (29.01.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.
 3. Paditëses Dž.E. për periudhën kohore 01.01.2021 – 21.11.2022 në shumën e përgjithshme prej 694.04 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (29.01.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.
 4. Paditësit L.S. për periudhën kohore 01.01.2021 – 21.11.2022 në shumën e përgjithshme prej 694.04 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (29.01.2024), e deri në pagesën

definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

5. Paditëses Dž.M. për periudhën kohore 01.01.2021 – 21.11.2022 në shumën e përgjithshme prej 694.04 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (29.01.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.
6. Paditësit A.P. për periudhën kohore 01.01.2021 – 21.11.2022 në shumën e përgjithshme prej 694.04 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (29.01.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, ashtu që secilit paditës veç e veç iu refuzua shuma prej 14.9 euro.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, që paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës, tua paguaj shumën prej 352.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësit S.D., R.B., Dž.E., L.S., Dž.M., A.P. që të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. A.S. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 29.01.2024 kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit-Prizren, me objekt të kontestit për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

I autorizuari i paditësve në padi ka theksuar, se paditësit janë të punësuar pranë SHFMU "SHARR" në fshatin Jabllanicë Komuna Prizren dhe duke u bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë, si dhe sipas raportit zyrtar- Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010- Prill 2022 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, konkretisht Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e inflacionit, ndër vite është dhe atë vitit 2021=3.4%, viti 2022= 11.6 %. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të bazuar duke kërkuar që paditësve ti kompensohet shuma prej 708.95 euro në emër të përqindjen mbi bazën e inflacionit për periudhën 01.01.2021-23.11.2022, gjithsej për 23 muaj. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 01.03.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të

Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK. Padi tësit ushtrojnë padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë padi tësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e padi tësive se ju takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e padi tësive ta refuzoj në tërësi si të pabazuar po ashtu edhe kërkesa e padi tësive ka theksuar se është parashkruar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpapia e padi tësive është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqësve të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga kontratat e lidhura në mes të paditurës SHFMU “SHARR” në Prizren dhe padi tësive, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se padi tësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “SHARR” në fshatin Jabllanicë Komuna Prizren, si mësimdhënës.

Nga vërtetimi me numër protokoll 120/23-21 e nënshkruar me datë 21.12.2023, lëshuar nga Drejtori i Shkollës SHFMU “SHARR” në Prizren, rezulton se padi tësja S.D. është e punësuar tek e paditura në periudhën 01.01.2020-22.11.2022.

Nga vërtetimi me numër protokoll 120/23-20 e nënshkruar me datë 21.12.2023, lëshuar nga Drejtori i Shkollës SHFMU “SHARR” në Prizren, rezulton se padi tësi R.B. është e punësuar tek e paditura në periudhën 01.01.2020-22.11.2022.

Nga vërtetimi me numër protokoll 120/23-10 e nënshkruar me datë 21.12.2023, lëshuar nga Drejtori i Shkollës SHFMU “SHARR” në Prizren, rezulton se padi tësi Lj.S. është e punësuar tek e paditura në periudhën 01.01.2020-22.11.2022.

Nga vërtetimi me numër protokoll 120/23-19 e nënshkruar me datë 21.12.2023, lëshuar nga Drejtori i Shkollës SHFMU “SHARR” në Prizren, rezulton se padi tësi Dž.E. është e punësuar tek e paditura në periudhën 01.01.2020-22.11.2022.

Nga vërtetimi me numër protokoll 120/23-7 e nënshkruar me datë 21.12.2023, lëshuar nga Drejtori i Shkollës SHFMU “SHARR” në Prizren, rezulton se padi tësja Dž.M. është e punësuar tek e paditura në periudhën 01.01.2020-22.11.2022.

Nga vërtetimi me numër protokoll 120/23-3 e nënshkruar me datë 21.12.2023, lëshuar nga Drejtori i Shkollës SHFMU "SHARR" në Prizren, rezulton se paditësja A.P. është e punësuar tek e paditura në periudhën 01.01.2020-22.11.2022.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëseve si mësimdhënës në SHFMU është në shumë prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *"Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të"*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *"Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë"*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *"Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve"* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëseve u takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Paditësve S.D., R.B., Dž.E., L.S., Dž.M., A.P. që të gjithë nga Prizreni:

- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është $421 * 3.4\% = 14.314$ (14.314 * 12 muaj = 171.72 euro),
- Për periudhën 01.01.2022 deri me dt. 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është $421 * 11.6\% = 48.832$ (48.832 * 10 muaj = 488.32 euro), si dhe periudha 21 ditë e muajit Nëntor 2022 është $48.832 / 30 = 1.6277$ (1.6277 * 21 = 34.18 euro),
- Pra secilit paditësit për këtë periudhë i takon shuma prej 694.04 euro.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *"Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë"*, ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese si në pikën nën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Gjykata e refuzoi si të pabazuar kërkesën e paditësve për në tërësi në muajin nëntor 2022, kjo pasi që bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme me numër GJ.A-Su.A 214/2023, të datës 09.10.2023, në pikën III, është përcaktuar se: Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur me datë 22.01.2021, aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021, e deri në datën 21.11.2022. Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësve sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë duke ia refuzuar pjesën e kërkesës së kërkuar edhe për muajin nëntor të vitit 2022 në tërësi, pra shuma e tërësishme e pabazuar për secilin paditës është në lartësi prej 14.9 euro.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës sa i përket parashkrimit të kërkesës mirëpo gjeti se është i pabazuar pasi që sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 29.01.2024, ndërsa kërkesa e tyre ka qenë për kompensimin e pagës mbi bazën e inflacionit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses nuk iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2021 deri më datë 32.11.2022. Pasi që paditësit e kanë ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tyre në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padsisë me dt. 29.01.2024.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashkrimit të padsisë në këtë gjykatë (29.01.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padsisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 40.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 352.00 euro. Ndërsa gjykata nuk ia njohu shpenzimet e kërkuara për përpilim të padsisë në shumë prej 624 euro, pasi që sipas Tarifës së Odës së Avokatëve përpilimi i parashtrësve është në vlerë prej 312.00 euro dhe jo 624.00 euro sa ka kërkuar i autorizuari i paditësve.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.549/2024, datë 09.10.2024

Gjyqtarja

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.